

✓ Si të shpenzojmë në mënyrë të duhur paratë?

Paratë duhet shpenzuar me shumë kujdes dhe mençuri. Në ditët e sotme ofrohen lloj-lloj produktesh për tu blerë me çmime të ndryshme. Andaj duhet të jeni shumë të kujdesshëm kur vendosni se cilin produkt duhet ta bleni. Paraprakisht, duhet të konsideroni faktin sa para kenë dhe a është çmimi i vulltshëm.

Në përgjithësi janë dy lloje produktesh: produkte esenciale (të nevojshme) dhe produkte jo-esenciale (të dëshirueshme).

✓ Produktet esenciale

Produktet esenciale - janë ato produkte të cilat na nevojiten në jetën e përditshme. Për shembull: ushqimi, uji, rrobat dhe strehimi.

✓ Produktet jo-esenciale

Produktet jo-esenciale - janë ato produkte që nuk janë të domosdoshme për jetën e përditshme. Ato janë thjeshtë gjëra që kemi dëshirë t'i posedojmë. Për shembull: lodrat, vetura, telefoni, etj.



Monedhat e ndryshme

Vendet e ndryshme të botës përdorin valuta të ndryshme. Për shembull, ne në Kosovë e përdorim valutën Euro; në Amerikë përdoret Dollari Amerikanë; në Shqipëri Leku, etj. Mirëpo këto valuta mund të këmbehen në mes vete për të lehtësuar pagesat. Këmbimi bëhet në Bankë ose në Këmbimore. Prandaj kur të shkoni në vizitë në Amerikë, parat duhet të këmbehen nga Euro në Dollarë, ose kur të shkoni në Shqipëri nga Euro në Lekë.

Meqë vendet e ndryshme përdorin monedha të ndryshme, edhe çmimet e produkteve ndryshojnë. Për shembull, nëse një hamburger në Kosovë ka vlerën 1 euro, ju këtë hamburger do ta bleni:



- në Shqipëri për 140 Lekë;
- në Maqedoni për 61 Denarë.



"Ky projekt u financua përmes grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit."

UNE DHE PARAJA

Edukimi financiar i fëmijëve



Email: info@fit-ks.org
Website: www.fit-ks.org

✓ Kursimi i parasë

Kursimi i parasë është mënyra më e mirë për të realizuar dëshirën e blerjes së produkteve që i pëlqeni. Kështu për shembull, çdo herë kur fitoni para ju mund të ndani së paku një përqindje të vogël të asaj shume në një arkë dhe pastaj kur nëna e ka ditëlindjen ju mund t'i merrni ato para që i keni kursyer dhe t'i bleni asaj një dhuratë të bukur.

✓ Banka

Secila para që nuk shpenzohet quhet para e kursyer. Me fjalë të tjera, nëse keni para dhe po prisni që t'i shpenzoni më vonë atëherë ju jeni duke kursyer. A e dini ju se mund të fitoni më shumë para nëse i ruani ato? Kjo është e mundur. Për shembull, nëse hapni një llogari kursimesh në bankë ju mund të fitoni më shumë para. Por cka është banka?

5 gjëra që ju duhet t'i bëni

- ✓ Bëni krahasimin midis euros, lekut dhe dollarëve;
- ✓ Llogaritni se sa para hargjoni gjatë javës;
- ✓ Gjeni mënyra se si t'i ruani paratë;
- ✓ Mësoni për institucionet që mirren me para (psh bankat);
- ✓ Bisedoni me tre të rritur rreth profesioneve të tyre.



Nënë,...
nga kursimet e mia, kam
bërë një dhuratë për Ty!



Banka është një vend i sigurtë për të ruajtur paratë. Por, banka nuk shërben vetëm për këtë arsye. Ato i përdorin paratë tuaja të cilat i ruani dhe ua japin hua (kredi) personave që kanë nevojë për ato para me një përqindje interesi. Para se të hapni një llogari bankare, është e rëndësishme të vendosni se në cilën bankë dëshironi të keni llogari. Arsyeja për këtë është se bankat e ndryshme ofrojnë shërbime të ndryshme dhe në bazë të interesave tuaja ju mund të vendosni se te cila bankë keni levërdi më shumë.

Është e rëndësishme që të bisedoni me tre të rritur të cilët kanë punë të ndryshme. Kështu, ata mund të ju tregojnë shumë gjëra rreth punës që e bëjnë. Duke i dëgjuar këto gjëra, ju kuptoni se kënaqësia e punës, orari i punës, apo qëndrimi në zyre janë më shumë ose më pak të rëndësishme se sa të hollat që ju mund ti fitoni.